



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr011/01-29520, datës 30.07.2019), duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës, me qellim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 nr. 011/01-29516 datës 30.07.2019 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, me datën 29.05.2020 rishpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK
Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Palujtëshme Komunale

Ftohen të gjithë të interesuarit personat fizik dhe juridik që të aplikojnë për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së palujtëshme komunale-kiosqet

Pronat e palujtëshme që do të jepen në shfrytëzim përmes njoftimit publik në afat prej 5 viteve janë kiosqet si ne vijim:

	Z. Kadastrale	Pjesë e Parcelës	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar m²
1	Gjakovë Z.K Qytet	1041-0	Ismail Qemajli - Te Lumi Krena	6 m ²	10€
2	Gjakovë Z.K Qytet	3404-1	Vëllezërit Frasheri - Te Ambullanta	6 m ²	10€
3	Gjakovë Z.K Qytet	398-1	Bardhyl Çausi - Te Gjykata	6 m ²	10€
4	Gjakovë Z.K Qytet	1782-0	Nënë Tereza - Te Komuna	6 m ²	10€
5	Gjakovë Z.K Qytet	3408-0	Nënë Tereza - Në Çarshi të Vogël	6 m ²	10€
6	Gjakovë Z.K Qytet	3307-1	Bardhyl Çausi - Te Drejtoria e Shëndetësisë	6 m ²	10€
7	Gjakovë Z.K Qytet	577-0	Bardhyl Çausi - Te Drejtoria e Shëndetësisë	6 m ²	10€
8	Gjakovë Z.K Qytet	3351-1	Sadik Stavileci - Te Stacioni i Autobusëve	6 m ²	10€
9	Gjakovë Z.K Qytet	468-1	Sadik Stavileci - Te Stacioni i Autobusëve	6 m ²	10€
10	Gjakovë Z.K Qytet	3351-1	Sadik Stavileci - Te Stacioni i Autobusëve	12 m ²	10€
11	Gjakovë Z.K Qytet	3375 - 1	Marin Barleti – Te Gjinnazi i Vjetër	12 m ²	10€
12	Gjakovë Z.K Qytet	3375-1	Marin Barleti – Te Center Malli	12 m ²	10€

13	Gjakovë Z.K Qytet	3307-1	Mbreteresha Teuta - Te Keds	6 m ²	10€
14	Gjakovë Z.K Qytet	3318-1	Bezistan - Te Kurrizi	6 m ²	10€
15	Gjakovë Z.K Qytet	1167-1	Marin Barleti - Te Stadiumi i Qytetit	6 m ²	10€
16	Gjakovë Z.K Qytet	33431-1	Nënë Tereza - Te parku Mustafa Bakija	6 m ²	10€
17	Gjakovë Z.K Qytet	3375-1	Marin Barleti – Te Reve Caffë	6 m ²	10€

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër i kiosqeve është:

- Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies së kiosqeve
- Funksionalizimi i kiosqeve

Kushtet e veçanta:

- Në lokacionet e cekura objektet në fjalë (kiosqet) do të shërbejnë për këto destinime:
Punkte shërbyese për gazeta, revista, prodhime të duhanit, galanteri, suvenire, akullore, ushqime të shpejta dhe afarizëm të ngjashëm
- Nuk lejohet të bëhet ndonjë destinim tjetër përveç atij që është përcaktuar më lartë;
- Shfrytëzimi i hapësirave të jashtme duhet të miratohet paraprakisht nga DUM-i, në bazë të rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Orari i punës të jetë sipas rregullores komunale në fuqi;
- Ndalohet çdo devijim nga plani fillestar i kiosqeve;
- Ndalohet shfrytëzimi i kiosqeve nga palët e treta;
- Aplikuesit mund të konkurrojnë vetëm për një kiosk;
- Pagesa e të gjitha komunalive që ndërlidhen me kiosqet, i bartë përfituesi;
- Vlera e çmimit fillestar është bazë e përcaktimit të çmimit;
- Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofruar në ankand publik
- Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mënyrë të komunës dhe fituesit (shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të komunës.)

Kushtet e përgjithshme të njoftimit publik:

1) Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore së paku deri në tremujorin e fundit para; dorëzimit të ofertës;
- Vërtetimin e tatimit në Pronë;
- Të ofroj dëshmitë financiare (si p.sh. Deklarata nga banka, kapitali vetanak, etj.);

2) Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës: pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në ueb – faqen e Komunës. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.

3) Komuna e Gjakovës mbanë të drejtën e dislokimit të kiosqeve sipas nevojës dhe planifikimit mjedisor urbanistik.

Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.

4) Periudha e vlefshmërisë së njoftimit publik do të jetë 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

5) Ofertat me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimi në katin përdhësë , 1 origjinal dhe 2 kopje, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.



Kryesues i Komisionit

Arben Bakalli